



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:069483

Datë: 28.01.2022

Numri i dokumentit: 02657985

P.nr.102/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Pergjithshem, Divizioni penal, Gjyqtarja individuale Zajrete Muhaxheri me zyrtarin – praktikantin Driton Rudi, në çeshtjen penale ndaj të pandehurve K.L dhe Xh. L. nga fshati ..., Komuna Kaçanik, per veprën penale Dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.460/2021 të datës 13.04.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 18.01.2022, në prezencë të Prokurorës së Shtetit Luljeta Bilalli, të dëmtuarës dhe të pandehurve, më datë 21.02.2022 mori dhe shpalli, ndërsa më datë 28.01.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1.K.L nga fshati ..., Komuna Kacanik,i lindur më datë ..., nga i ati B...dhe e ema Xh..., e gjinisë J..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosoves, i martuar, prind i 3 fëmijëve, ka të kryer Shkollën e Mesme, punëtor privat, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal:

2.Xh. L. nga fshati ..., Komuna Kacanik, e lindur më datë ..., nga e ati H... edhe e ëma V..., e gjinisë Sh..., Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës, e martuar, nënë i 3 fëmijeve, ka të kryer Shkollën e Mesme, e pa pune, e gjendjës së mesme ekonomike, me numër personal ...

JANË FAJTORË

Që nga viti 2020, në periudhën kohore prej shtatë muajve, në fshatin Begracë, Komuna Kaçanik, saktësisht në shtëpinë e tyre, të pandehurit në bashkëkryerje kanë ushtruar dhunë psikologjike ndaj të dëmtuarës – vajzës së tyre E. L., në atë mënyrë që e mbanin nën shqetësim të vazhdueshëm emocional duke e izoluar dhe mbajtur në kontrollë të vazhdueshme, për faktin se e dëmtuara, muaji Gusht 2020, pasi që ajo kishte pasur lidhje dashurie me një person që ishin në dijeni edhe prindërit e saj, kishte ikur nga shtëpia me atë person dhe pas disa ditësh ishte kthyer prapë ku të pandehurit që nga atëhere e mbanin nën kontrollë, duke ia cenuar lirinë si dhe e pengojnë atë që të punësohet dhe të jetë e lirë, kurse më datë 27.03.2021, rreth orës 22:00, e dëmtuara nga dhuna e ushtruar largohet nga shtëpia e cila edhe e paraqet rastin në Polici,-

Me këto veprime të pandehurit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, Dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në baze të nenit 81 dhe 82 të KPRK-se, se dhe nenit 498,499 dhe 500 të KPPK-se u shqipton,

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilën të pandehurve K.L dhe XH.L, u bëhet me dije se kanë kryer veprën penale të denueshme dhe poqese sërish kryejnë veprën të tillë gjykata do t'u shqiptojë sanksion penal më të rreptë.

Detyrohen te pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajne pranë kësaj gjykate secili veq e veq shumën prej 10,00 € , ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit poashtu secili veq e veq shumën prej 15€, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

E demtuara E. L. nuk ka parashtruar kerkese pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.460/2021 të datës 13.04.2021, të pandehurit i ka akuzuar për veprën penale Dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të nëjtit të shpallen fajtorë dhe te gjykohen sipas ligjit.

Ne baze te kësaj aktakuze gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar më datë 18.01.2022 , me të cilin rast, prokuroria e shtetit Luljeta Bilalli deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës së parashtruar pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotësime.

E dëmtuara E. L. në fjalën e saj ka deklaruar se, nuk i bashkangjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore – juridike ndaj të pandehurve, meqë tani kanë raporte të mira dhe e njëjta e ka kuptuar që prindërt e saj i kanë folur për të mirë, gjeqësisht ka qenë në interesin e saj dhe thekson se më nuk ka pasur problem me ta.

I pandehuri K.L ne fjalën e tij ne shqyrtimin fillestar, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për te cilën e ngarkon aktakuza dhe shton shtonë faktin se ndihet i penduar për veprimin e tij dhe se në të ardhmen pavarësisht rrethanave do të jetë më i kujdesshëm për të mos ardhur situata te ngjashme dhe me që është hera e parë që është në Gjykatë, kërkon nga gjykata që me rastin e marrjes së vendimit, t'i shqiptohet një dënim sa më i vogël që të jetë e mundur.

E pandehura XH.L në fjalën e saj, në pytjen e gjyqtares deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza, dhe e cila poashtu ndihet e penduar per veprimin e

saj, por qe ne te ardhmen premtion se pavarësisht rrethanave, do të jetë më e kujdesshme për të mos u perseritur siuate te tilla, andaj meqë është hera e parë që është në gjykatë, i kërkon gjykatës që me rastin e marrjes se vendimit t'i shqiptohet një dënim sa më i ulët që është e mundur.

Prokurorja e shtetit ne fjalën e saj është dakorduar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 248 të KPK pasi që formoi bindjen se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes qe përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve manifestohen te gjitha tiparet e veprës penale, Dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit te dënimit gjykata pati parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 te KPRK-së, ashtu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se të pandehurit e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën i ngarkon aktakuza ne shqyrtimin fillestar , jane shprehur të penduar per veprimin e tyre, kane premtuar se në të ardhmen, pavarësisht rrethanave, do të jenë më të kujdesshëm për të mos përsëritur veprime të tilla, ndërsa rrethanë te posaçme rënduese gjykata nuk gjeti, përpos veprimeve të të pandehurve te cilat paraqesin tiparet e veprave penale për te cilat janë shpallur fajtorë.

Andaj, për këto arsye gjykata te pandehurve , për veprën penale, Dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i gjykoi me dënim si në dispozitiv të ketij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është ne proporcion me veprën si dhe sjelljen e te pandehurve, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura, personalitetin e te pandehurve, andaj edhe konsideron se ky dënim do te ndikojë pozitivisht tek të pandehurit dhe personat tjerë qe te mos kryejnë vepra te tilla penale dhe se me këtë do të arrihet ne tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 te KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 450 par 2 të KPPK-se.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 39 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

E dëmtuara nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr.102/21 datë 28.01.2022

Zyrtari-Praktikanti,

Driton Rudi

Gjyqtarja,

Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.